



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 2 gusht 2021
Nr. ref.:RK1821/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI187/20

Parashtrues

Lorik Saliu

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së
Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, PN. nr. 558/2020, të 18 gushtit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Lorik Saliu, nga Gjakova (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Edona Sina, avokate nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi [PN. nr. 558/2020] i 18 gushtit 2020 i Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Apelit) në lidhje me Aktvendimin [PPr. Kr. nr. 33/20] të 13 korrikut 2020 të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës, Aktvendimin [PN. nr. 558/2020] e 18 gushtit 2020 të Gjykatës së Apelit, e ka pranuar më 26 gusht 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit, përmes së cilit parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 21 dhjetor 2020, parashtruesi i kërkesës, nëpërmjet postës, dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 30 dhjetor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
8. Më 14 janar 2021, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që, në përputhje me nenin 21 të Ligjit dhe rregullin 32 (2) (c) të Rregullores së punës, të dorëzojë në Gjykatë autorizimin për përfaqësim të parashtruesit të kërkesës.
9. Më 20 janar 2021, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi para Gjykatës autorizimin për përfaqësim.
10. Më 16 mars 2021, Gjykata njoftoi Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës.

11. Më 12 prill 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një parashtrësë, përmes së cilës plotësoi pretendimet e tij.
12. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
13. Më 18 maj 2021, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore në Gjakovë për regjistrim të rastit dhe kërkoi nga ta që të dorëzojnë në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës ka pranuar vendimin e kontestuar.
14. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
15. Më 31 maj 2021, Gjykata Themelore në Gjakovë, dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar.
16. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
17. Më 30 qershor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

18. Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se më 8 qershor 2020, Prokuroria Themelore në Gjakovë, përmes kërkesës [PP/I. nr. 36/20] drejtuar Gjykatës Themelore, kishte kërkuar vendosjen e urdhëresës për sekuestrim të përkohshëm të automjetit “BMW 335 D” (në tekstin e mëtejme: automjeti) të parashtruesit të kërkesës, duke theksuar se ekziston dyshimi i bazuar se i njëjti është përdorur nga parashtruesi i kërkesës për qëllime të kryerjes së veprës penale “*Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge*” nga neni 267, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 “*Bashkëkryerja*” të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK).
19. Më 11 qershor 2020, Gjykata Themelore përmes Urdhëresës [PPr. Kr. nr. 33/20] duke u bazuar në paragrafin 1, 3 dhe 5 të nenit 112 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPRK-së) kishte urdhëruar sekuestrimin e përkohshëm të automjetit, të parashtruesit të kërkesës, duke

theksuar se “*është e domosdoshme sekuestrimi i përkohshëm i automjetit të bëhet me qëllim të verifikimit të kryerjes së veprës penale*”.

20. Më 10 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën Themelore kundër Urdhërësës së lartpërmendur të Gjykatës Themelore, me propozimin që e njëjta të pushohet, duke u thirrur në paragrafin 1 të nenit 116 të KPPRK-së. Parashtruesi i kërkesës, më tej kishte pretenduar se sekuestrimi i automjetit në këtë rast nuk është më i nevojshëm, duke theksuar se pas kontrolleve të nevojshme nga zyrtarët policorë, nuk ka asnjë bazë që automjeti të mbetet i sekuestruar edhe më tutje.
21. Më 13 korrik 2020, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [PPr. Kr. nr. 33/20] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke theksuar se “*me këtë rast ekziston dyshimi i bazuar se automjeti i sekuestruar nga i pandehuri është përdorur për kryerjen e kësaj vepre penale, gjë që shihet edhe nga fotografitë që janë prova në lëndë*”. Aktvendimi i Gjykatës Themelore u vendos në bazë të nenit 112 dhe 417 të KPPRK-së.
22. Në këshillën juridike të Aktvendimit [PPr. Kr. nr. 33/20], parashtruesi udhëzohet sipas mjetit juridik - ankesa kundër aktvendimit të lartpërmendur lejohet në afat prej 3 ditësh në Gjykatën e Apelit.
23. Më 22 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar zbatim të gabuar të dispozitave penale.
24. Më 18 gusht 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PN. nr. 558/2020] kishte hedhur poshtë si të palejuar ankesën e parashtruesit me arsyetimin se “*Ankesa është e palejuar*” duke theksuar se gjykata e shkallës së parë gabimisht kishte udhëzuar parashtruesin e kërkesës me këshillën juridike dhe se pretendimet e tilla në bazë të nenit 417.5 [Shqyrtimi nga Kolegji shqyrtues i Gjykatës Themelore] të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPRK) mund të parashtrohen vetëm përmes ankesës ndaj aktgjykimit final. Gjykata e Apelit Aktvendimin e saj e bazoi në nenin 400 lidhur me nenin 416, paragrafi 2 të KPPRK-së.
25. Më 23 tetor 2020, parashtruesi i kërkesës në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, përmes Kërkesës [PP/I.nr.36/20] kishte kërkuar kthimin e automjetit.
26. Nga shkresat e rastit rezulton se deri më tani Prokuroria Themelore në Gjakovë nuk ka kthyer përgjigje në kërkesën e lartcekur të parashtruesit të kërkesës për kthimin e automjetit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi [PN. nr. 558/2020] i 18 gushtit 2020 i Gjykatës së Apelit, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së.

28. Lidhur me pretendimin për shkeljen e nenit 32 të Kushtetutës, parashtruesi thekson se “I pandehuri përmes mbrojtëses së tij ka parashtruar ankesë kundër vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës Themelore në Gjakovë, bazuar në nenin 24 par.6 të Kodit të Procedurës Penale, ku është përcaktuar se: “afati për paraqitje të ankesave kundër vendimeve të gjyqtarit të procedurës paraprake apo të Kolegjit shqyrtues është pesë ditë prej kur pala e pranon vendimin, në pajtim me nenin 378.”, mirëpo Gjykata e Apelit, si gjykatë kompetente për të vendosur lidhur me këtë ankesë e ka hedhur si të palejuar ankesën e mbrojtjes me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka udhëzuar me këshillën juridike dhe se pretendimet e tilla mund të parashtrohen vetëm përmes ankesës ndaj aktgjykimit final”.
29. Parashtruesi më tej shton se “në rastin konkret mjeti juridik ka qenë në dispozicionin e parashtruesit, dhe i njëjti e ka shfrytëzuar atë në përrputhje me dispozitat ligjore. Megjithatë efektiviteti i tij ka qenë inekzistent, si pasojë e mostrajtimit meritor. Rrjedhimisht ka sjellur deri tek shkelja e nenit 31 të Kushtetutës [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 32 [E drejta për Mjet Juridik], neni 13 i KEDNJ-së, meqë autoritetet vendase të cilat vendosin lidhur me rastin duhen të shqyrtojnë bazueshmërinë/meritat e kërkesës që rrjedh nga Konventa (shih, mutatis mutandis, Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 20 shtator 1999, Smith dhe Grady kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.33985/96dhe 33986/96par,138)duke supsimuar faktet e parashtruesit nën ombrellën e jurisprudencës së GJEDNJ-së si dhe nenit 13 të KEDNJ-së, konkretisht mund të thuhet se: legjislacioni ynë e ka paraparë parashtrimin e ankesës kundër aktvendimit të kolegjit penal/shqyrtues, mjet ky që ka qenë i qasshëm ligjërisht, mirëpo në praktikë është provuar tërësisht inefektiv - si pasojë e interpretimit flagrant të dispozitave ligjore nga ana e Gjykatës së Apelit - interpretim ky që ka rezultuar të mos lëshohet fare në meritat e rastit - dhe ka sjellë deri te cenimi i të drejtës për mjet efektiv juridik të paraparë me nenin 32 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 13 të KEDNJ-së”.
30. Parashtruesi i kërkesës më tej thekson se vendimi i kontestuar është kontradiktor për faktin se sipas tij dispozita e paragrafit 5 të nenit 417 të KPPK-së, vlen vetëm me përjashtim të rasteve, dhe sipas tij jo edhe në rastin konkret.
31. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Dispozitat relevante ligjore

Kodi 04/L-123 i Procedurës Penale

Neni 24

[Urdhrat dhe vendimet e gjyqtarit të procedurës paraprake]

[...]

6. Afati për paraqitje të ankesave kundër vendimeve të gjyqtarit të procedurës paraprake apo të Kolegjit shqyrtues është pesë (5) ditë prej kur pala e pranon vendimin, në pajtim me nenin 378 të këtij Kodi.

Neni 116

[Kthimi i sendeve të sekuestruara përkohësisht]

1. Sendet e sekuestruara përkohësisht gjatë procedurës penale i kthehen pronarit ose poseduesit kur procedura pezullohet ose pushohet dhe kur nuk ka bazë për konfiskimin e tyre.

Neni 378

[Afati për paraqitjen e kundërshtimit, kërkesës për mjet juridik dhe përgjigjes]

1. Kundërshtimi i cili shqyrtohet nga Kolegji shqyrtues duhet të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj.

2. Kërkesa e cila shqyrtohet nga Gjykata e Apelit duhet të paraqitet brenda pesë (5) ditëve nga aktgjykimi apo aktvendimi i formës së prerë, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj.

3. Kërkesa e cila shqyrtohet nga Gjykata Supreme e Kosovës duhet të paraqitet brenda dhjetë (10) ditëve, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj.

4. Përgjigja në kundërshtim duhet të paraqitet brenda njëzet e katër (24) orëve nga kundërshtimi i cili shqyrtohet nga Kolegji shqyrtues.

5. Përgjigja në kërkesë duhet të paraqitet brenda pesë (5) ditëve nga kërkesa e cila shqyrtohet nga Gjykata e Apelit.

6. Përgjigja në kërkesë duhet të paraqitet brenda dhjetë (10) ditëve nga kërkesa e cila shqyrtohet nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Neni 400

[Hedhja e ankesës së palejueshme]

Gjykata e Apelit me aktvendim e hedh ankesën si të palejueshme kur konstaton se është paraqitur nga personi pa të drejtë ankese ose nga personi që ka hequr dorë nga ankesa, apo kur ankesa është tërhequr, ose kur ankesa e tërhequr paraqitet sërish apo ankesa nuk është e lejuar me ligj.

Neni 417

[Shqyrtimi nga Kolegji shqyrtues i Gjykatës Themelore]

[...]

5. Përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë Kod, aktvendimi i Kolegjit shqyrtues mbi kundërshtimin shqyrtohet nga Gjykata e Apelit vetëm në bazë të ankesës kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore.

Pranueshmëria e kërkesës

32. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

34. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë siç janë të përcaktuara me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 (Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49 (Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

35. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [PN. nr. 558/2020] të 18 gushtit 2020, të Gjykatës së Apelit, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me Ligj.

Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

36. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) në veçanti përcakton që:

Rregulli 39
(Kriteret e pranueshmërisë)

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

37. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
38. Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me sekuestrimin e automjetit të parashtruesit të kërkesës, i cili është bërë me kërkesë të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, kërkesë kjo e miratuar nga Gjykata Themelore, nën dyshimin se automjeti i sekuestruar është përdorur nga parashtruesi i kërkesës për kryerjen e veprës penale, të cilën vepër dyshohet se e ka kryer. Parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën Themelore, kundër Urdhrit për lejimin e sekuestrimit të veturës. Gjykata Themelore kishte refuzuar ankesën, dhe në këshillën juridike të Aktvendimit të saj ishte shënuar që ndaj të njëjtit vendim, palët mund të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në afat prej 3 (tri) ditësh. Pas ankesës së parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit, kishte hedhur poshtë ankesën si të palejuar, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë e kishte keq udhëzuar parashtruesin, pasi që bazuar në nenin 417, paragrafin 5 të KPPRK-së në këtë rast specifik nuk është e lejuar ankesa.
39. Gjykata rikujton edhe një herë pretendimet e parashtruesit për shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.
40. Së pari, lidhur me nenin 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës vetëm ka përmendur por nuk ka elaboruar apo arsyetuar tutje se si ka ardhur deri tek shkelja e të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me këtë nen.

41. Lidhur me pretendimin e lartcekur të parashtruesit për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, Gjykata thekson se fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e Aktvendimit të Gjykatës Apelit apo vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33)
42. Së dyti, lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se atij i është cenuar e drejta në mjet juridik, sepse sipas tij ankesën e tij të parashtruar në Gjykatën e Apelit e kishte bazuar në nenin 24 në ndërlidhje me nenin 378 të KPPRK-së, si dhe duke u bazuar në këshillën juridike të Aktvendimit [PPr. Kr. nr. 33/20] të Gjykatës Themelore, e cila parasheh se *"Kundër këtij Aktvendimi, është lejuar ankesa në afat prej 3 ditësh, pas marrjes së tij, Gjykata e Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj Gjykate"*.
43. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se mjeti juridik kishte qenë në dispozicion të parashtruesit dhe i paraparë me dispozita ligjore. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se vendimi i kontestuar është kontradiktor, duke shtuar se sipas tij dispozita e paragrafit 5 të nenit 417 të KPPK-së, vlen vetëm me përjashtim të rasteve, dhe sipas tij jo edhe në rastin konkret.
44. Në shqyrtimin e këtyre pretendimeve, Gjykata thekson se pretendimi i tij përkitazi me shkelje të nenit 32 të Kushtetutës në esencë ndërlidhet me interpretim të gabuar të ligjit të aplikueshëm nga Gjykata e Apelit, pretendime të cilat, Gjykata në përputhje me praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, i konsideron si pretendime që hyjnë në sferën e ligjshmërisë, dhe rrjedhimisht *"pretendime të shkallës së katërt"*.
45. Në këtë kontest, Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, pretendimet kryesore të parashtruesit të kërkesës ndërlidhen me interpretimin e paragrafit 5 të nenit 417 të KPPRK-së, nga ana e Gjykatës së Apelit, e cila duke u thirrur në nenin e lartcekur, ankesën e parashtruesit të kërkesës, të ushtruar kundër Aktvendimit [PPr. Kr. nr. 33/20] të 13 korrikut 2020 të Gjykatës Themelore, e kishte hedhur poshtë si të palejuar dhe në këtë mënyrë i kishte shkelur të drejtën për mjet juridik, duke ia mohuar parashtruesit të kërkesës përdorimin e mjetit juridik i cili, sipas parashtruesit të kërkesës, ishte ekzistent në bazë të nenit 24 në ndërlidhje edhe me nenin 378 të KPPRK-së.
46. Gjykata fillimisht vëren se Aktvendimi [PPr. Kr. nr. 33/20] i 13 korrikut 2020, të Gjykatës Themelore ishte nxjerrë nga trupi gjykues në përbërje prej tre gjyqtarësh dhe esenca e rastit kishte të bënte me çështjen e provave të mbledhura në procedurë paraprake penale.
47. Gjykata Themelore në këtë rast duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruesit, të ushtruar kundër Urdhëresës së Gjykatës Themelore, me të cilën ishte urdhëruar sekuestrimi i përkohshëm i automjetit, të parashtruesit të kërkesës, me qëllim të verifikimit të kryerjes së veprës penale, përmes Aktvendimit kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës.

48. Gjykata vëren se neni 116 i KPPRK-së parasheh se “Sendet e sekuestruara përkohësisht gjatë procedurës penale i kthehen pronarit ose poseduesit kur procedura pezullohet ose pushohet dhe kur nuk ka bazë për konfiskimin e tyre”.
49. Gjykata, megjithatë thekson se Gjykata e Apelit, e kishte trajtuar ankesën e parashtruesit të kërkesës të ushtruar kundër Aktvendimit [PPr. Kr. nr. 33/20] të 13 korrikut 2020, të Gjykatës Themelore dhe duke u bazuar në nenin 417.5 të KPPRK-së të njëjtën e kishte hedhur poshtë si të palejuar. Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [PN. nr. 558/2020], të 18 gushtit 2020, në këtë kontekst, kishte theksuar si në vijim:

“ Gjykata e Apelit, gjen se ankesa e ushtruar nga mbrojtësja e të pandehurit Lorik Salihu, av.Edona Sina, kundër vendimit të Kolegjit shqyrtues të Gjykatës Themelore është e palejuar, kjo pasi që bazuar në dispozitën e nenit 417, par. 5 të KPPRK-se, parashihet që: "Përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë Kod, aktvendimi i Kolegjit shqyrtues mbi kundërshtimin shqyrtohet nga Gjykata e Apelit vetëm në bazë të ankesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore ", e që në rastin konkret Gjykata e Apelit konstaton se gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka udhëzuar të pandehurin për të drejtën e ushtrimit të mjetit juridik. Andaj, meqenëse në rastin konkret nuk lejohet treshkallshmëria e mjeteve juridike me përjashtim të rasteve të parapara me ligj, ankesa e mbrojtëses së të pandehurit u hodh si e palejuar”.

50. Në adresimin e pretendimit të lartcekur, Gjykata fillimisht sjell në vëmendje dispozitën e nenit 32 të Kushtetutës, ku përcaktohet:

Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

51. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se neni 417.5 i KPPRK-së, në të cilin u thirr Gjykata e Apelit, në pjesën relevante thekson si në vijim:

[Shqyrtimi nga Kolegji shqyrtues i Gjykatës Themelore]

[...]

“5. Përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë Kod, aktvendimi i kolegjit shqyrtues mbi kundërshtimin shqyrtohet nga Gjykata e Apelit vetëm në bazë të ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës themelore.”

52. Në vijim të asaj çka u tha më lart, Gjykata vëren se vetë përmbajtja e dispozitës ligjore të nenit 417, paragrafit 5 të KPPRK-së është e pakontestueshme dhe se ankesa, mund të ushtrohet vetëm kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, pra vendimit të nxjerrë përkitazi me meritat e rastit.
53. Gjykata thekson se realizimi i të drejtës për mjet juridik, duke përfshirë edhe bazat për shfrytëzimin e tij, rregullohen me ligj. Ky nen plotësohet dhe lexohet në

lidhshmëri edhe me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, si dhe me praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës dhe GJEDNJ-së.

54. Rrjedhimisht, neni 13 i KEDNJ-së kërkon që kur një individ ka një pretendim të argumentueshëm për të qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të përcaktuara në Konventë, në ato rrethana ai duhet të ketë një mjet juridik para një "autoriteti" kombëtar në mënyrë që të vendoset kërkesa e tij; dhe nëse është e përshtatshme, të marrë dëmshpërblim (shih rastet e GJEDNJ-së: *Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i 6 shtatorit 1978, paragrafi 64; *Silver dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 25 marsit 1983, paragrafi 113; *Leander kundër Suedisë*, Aktgjykim i 26 marsit 1987, paragrafi 77 (a), po ashtu shih rastin e Gjykatës, KI62/20, parashtues *Gekos Sh.p.k*, Akvendim për papranueshmëri, i 24 shkurtit 2021, paragrafi 48, KI130/19, parashtues *Fahri Mati*, Akvendim për papranueshmëri, i 27 nëntorit 2019, paragrafi 50).
55. Megjithatë, GJEDNJ ka theksuar që neni 13 i KEDNJ-së nuk mund të interpretohet në atë mënyrë që kërkon një mjet juridik në të drejtën vendore për sa i përket secilës ankesë të supozuar që një individ mund të ketë, pa marrë parasysh se sa jo meritore mund të jetë ankesa e tij: ankesa dhe pretendimi duhet të jenë të "argumentueshme" për sa i përket KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së: *Boyle dhe Rice kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 27 prillit 1988, paragrafi 52; *Maurice kundër Francës*, Aktgjykim i 6 tetorit 2005, paragrafi 106).
56. Bazuar në parimet e lartcekura, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtuesit të kërkesës nuk është i argumentueshëm, pasi që KPPRK, në nenin 417.5 parasheh, "Akvendimi i Kolegjit shqyrtues mbi kundërshtimin shqyrtohet nga Gjykata e Apelit vetëm në bazë të ankesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore".
57. Duke iu rikthyer kësaj çështjeje, Gjykata do të vlerësojë nëse këshilla për mjetin juridik në vendimin e Gjykatës Themelore në ndonjë mënyrë a e ka penguar parashtuesin e kërkesës që të shqyrtohet pretendimi i tij ankimor nga gjykata e instancës më të lartë, në rastin konkret të Gjykatës së Apelit, ku ai do të mund të kishte ushtruar të drejtat e tij nga kërkesëpadia, ose mohimi i përdorimit të këshillës për mjetin juridik e Gjykatës Themelore kishte mohuar drejtpërdrejt të drejtën e parashtuesit për një mjet efektiv juridik, dhe me këtë drejtpërdrejt ka ardhur deri të shkelja e nenit 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së.
58. Në dritën e asaj që u tha më lart, Gjykata konstaton se pavarësisht nga e drejta kushtetuese për një mjet efektiv juridik, është e rëndësishme të theksohet se jo çdo udhëzim i gabuar për një mjet juridik do të rezultojë në shkelje të së drejtës për mjet efektiv juridik.
59. Dhe për më tepër në kuptimin e mjetit juridik, parashtuesi nuk mund të thirret në faktin që gjykata e shkallës së parë gabimisht autorizoi (udhëzoi) palën që ka të drejtë të apelojë kundër vendimit të Gjykatës Themelore, pasi që një udhëzim i tillë i gabuar në një situatë specifike ligjore nuk mund të zëvendësojë normën e qartë ligjore e cila për situata të tilla nuk parasheh mjet ankimi, siç parashihet me nenin 417.5 të KPPRK-së.

60. Gjykata rithekson se refuzimi i ankesës në fjalë nuk e cenon të drejtën e parashtruesit për mjet juridik sepse ai mund të ushtroj të drejtën e tij për çështjen lidhur me rastin konkret përmes një ankese kundër aktgjykimit final (shih në mënyrë të ngjashme rastin e Gjykatës, KI145/13, parashtrues Agjencia Kosovare e Privatizimit, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 marsit 2014, paragrafi 46).
61. Gjykata, në fund, rikujton se parashtruesi i kërkesës, në mbështetje të pretendimeve të tij për shkelje të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] iu referua edhe një rasti të GJEDNJ-së [...*“Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 20 shtator 1999, Smith dhe Grady kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.33985/96dhe 33986/96par,par138”*...]. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se në rastin e referuar nga parashtruesi i kërkesës, GJEDNJ në vlerësimin e meritave të kërkesës, ndryshojnë plotësisht nga rrethanat faktike dhe juridike të rastit të parashtruesit të kërkesës. GJEDNJ në rastin në të cilin thirret parashtruesi i kërkesës kishte gjetur shkelje të nenit 8 në ndërlidhje me nenin 13 të KEDNJ-së.
62. Megjithatë, Gjykata vëren se përveç faktit që parashtruesi i kërkesës i është referuar këtij rasti në kërkesën e tij, ai në asnjë mënyrë nuk elaboroi lidhshmërinë e tyre, faktike apo juridike, me rrethanat e rastit konkret, detyrë kjo që, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i takon parashtruesit të kërkesës (shih, ndër të tjera, dhe në këtë kontekst, Aktgjykimin në rastin KI48/18 të 4 shkurtit 2019, me parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)*, paragrafi 275; dhe rastin KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 majit 2019, paragrafi 80).
63. Duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta të shtjelluara më lart, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës. Për pasojë, Gjykata konstaton se ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
64. Prandaj në këto rrethana, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk i ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me Kushtetutë.
65. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe e njëjta deklarohet e papranueshme, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 30 qershor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvetë Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

Gresa Caka-Nimani